




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Pagesat e vendimeve gjyqësore në vlerë 270,224€ ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate;
- C1 Blerjet e inventarit gjatë vitit 2023 në vlerë 75,126€, nuk ishin regjistruar në sistemin e pasurisë, duke nënvlerësuar regjistrin e pasurisë jo kapitale për këtë vlerë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Ne kemi identifikuar se në dy raste, KGJK kishte shpërblyer me kontratë OE të cilët kishin ofertuar me çmime jo normalisht të ulët.
- B1 Në tetë raste në vlerë totale prej 34,599€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga 30 ditë deri në 109 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Sekretariatit dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i KGJK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve dhe pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18, paragrafi 3 të rregullores financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate ekonomike, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11, i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë të regjistruara në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Dy pagesa në vlerë 270,224€ që kishin të bënin me kompensimin e dëmit për persona të arrestuar apo dënuar pa arsye, ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Thesari përmes vendimeve gjyqësore kishte kryer këto pagesa nga kategoria e investimeve kapitale të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.

Kjo kishte ndodhur për shkak se në kategoritë përkatëse nuk kishin mjete të mjaftueshme për ekzekutimin e këtyre pagesave, përkundër kërkesave të vazhdueshme të KGjK-së për buxhet shtesë me qëllim të mbulimit të këtyre shpenzimeve.

Ndikimi

Pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate vështirëson realizimin e buxhetit sipas planifikimeve dhe ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke reflektuar kështu në prezantimin jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i KGjK-së duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Nënvlërësimi i pasurisë jo kapitale

Gjetja Neni 6.3 i rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Ne kemi identifikuar që inventari (karrika, tavolina dhe vitrina) i blerë gjatë vitit 2023 në vlerë 75,126€ nga njësitë administrative të KGjK-së, nuk ishte regjistruar në regjistrin e sistemit e-pasuria.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës në njësitë administrative të KGjK-së për regjistrimin e pasurisë dhe mungesës së mbikëqyrjes nga kontrollet në nivel të përgjithshëm të organizatës.

Ndikimi Mos regjistrimi i vlerës së saktë të pasurisë jo kapitale ka ndikuar në nënvlerësimin e regjistrit të pasurisë, duke shkaktuar prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV.

Rekomandimi C1 Kryesuesi i KGjK-së duhet të siguroj që blerjet e pasurisë jokapitale të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Dhënia e kontratës me çmime jo-normalisht të ulët për pozicione të caktuara

Gjetja

Sipas neni 61, të Ligjit të Prokurimit Publik, për tenderët jo normalisht të ulët, nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni. Më tutje sipas 41.9 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, në rast se një tender duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet. Po ashtu neni 41.6 parasheh se në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, AK duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

Ne kemi identifikuar se në dy raste, KGJK kishte shpërblyer me kontratë OE të cilët kishin ofertuar me çmime jo normalisht të ulët. Kjo ishte bërë në mungesë të një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë sipas formularit standard të miratuar nga KRPP-ja "*Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët*", siç kërkohet me rregullat e prokurimit në këto raste. Detajet për këto raste janë prezantuar në vijim:

- Në procedurën "Renovimi i objektit të Gjykatës Themelore Mitrovicë - Jug" në vlerë 1,274,867€, OE fitues kishte ofertuar me çmim 1€ për këto pozicione: dy(2) lifta/ashensorë, 15 dyer zjarr qëndrueshme me akses kontroll, një (1) derë të Trezorit zjarr qëndrueshme, 121 dyer të aluminit me dimensione të ndryshme, 41 dritare alumini me dimensione të ndryshme, një (1) pompë automatike për largimin e ujit, tavolinë me konstruksion inoksi dhe knauf ujë rezistent dhe renovimin e shkallëve emergjente metalike.
- Në procedurën "Furnizim me inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për gjykata dhe SKGJK," në vlerë indikative 2,790€ dhe vlerë totale 500,000€, OE fitues kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulët në dy pozicione, si: tavolina për takime për 22 persona, me çmim prej 40€/copë, dhe tavolina për takime për 8 persona, me çmim prej 35€/copë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në procesin e vlerësimit të tenderëve, pasi që ofertat janë vlerësuar si total dhe jo për nën totale apo pozicione.

Ndikimi

Çmimet jo normalisht të ultë për pozicionet e caktuara, mund të kenë qenë përcaktuese në shpërblyerjen me kontratë, duke ndikuar në eliminimin nga konkurrenca të OE-ve që kanë ofertuar me çmime tregut. Mungesa e sqarimeve shtesë nga OE, mund të ndikojë në mos përmbushjen e

kontratës për pozicionet përkatëse.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë kontrolle efektive tek komisionet e vlerësimit dhe tek zyra e prokurimit me rastin e vlerësimit të tenderëve, ashtu që vlerësimi të bëhet në pajtim me rregullat e prokurimit për të mundësuar konkurrencë të shëndoshë dhe implementim të plotë të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Vonesa në pagesa të obligimeve

Gjetja Neni 39 i LMFPP, specifikon se, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim, për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe /ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në tetë raste në vlerë totale prej 34,599€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga 30 ditë deri në 109 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos aprovimit të transferit të mjeteve në kategorinë përkatëse me qëllim të mbulimit të borxheve nga Ministria e Financave të Punës dhe Transfereve (MFPT) në fund të vitit dhe në mungesë të kontrolleve në menaxhimin e borxheve.

Ndikimi Vonesa në pagesën e obligimeve mund ta bëjë KGJK-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen në brenda afatit prej 30 ditëve nga pranimi i faturës, me qëllim të menaxhimit të duhur të fondeve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike: mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale.

Çështja A3 - Mos përdorimi i modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin të performancës së kontraktuesve

Gjetja

Neni 70.2 dhe 70.24.f. i Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, parasheh se vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave. Përgjegjësitë e menaxherit të kontratës janë që të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik. Ndër kërkesat e rëndësishme të këtij moduli është që menaxheri i kontratës duhet që të regjistrojë kopjet e gjitha faturave për punimet, shërbimet apo furnizimet përfshirë letrat e punës që verifikojnë saktësinë e pagesave të kërkuara dhe detajet e pagesave të kryera, të autorizuara nga menaxheri i kontratës në sistemin e prokurimit elektronik

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se në gjashtë kontrata, nuk është përdorur moduli i e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve nga menaxherët e kontratave.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme të menaxherëve të kontratave dhe në anën tjetër si rezultat i mos kryerjes së punëve me përgjegjësi nga ana e mbikëqyrësve të kontratave.

Ndikimi

Mungesa e vlerësimin të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhim jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të merr informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

Rekomandimi A3

Kryesuesi i KGjK-së duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuria kapitale neto e prezantuar në pasqyrat financiare është 18,784,161€, ndërsa ajo jo kapitale 2,162,813€. Vënia në funksion e sistemit e-pasuria dhe regjistrimi i pasurisë jo kapitale mbetet sfidë për KGjK-në, si rrjedhojë janë identifikuar mangësitë e mëposhtme.

Çështja C2 - Mos përdorimi i e-pasurisë për material shpenzues/stoqe dhe mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë me raporte të inventarizimit

Gjetja Rregulla e MF-02/2013, neni 6, pika 3 përcakton se pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu, neni 19 i të njëjtës rregullore përcakton që, komisioni për inventarizimin e pasurisë të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë dhe të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

KGjK gjatë vitit 2023, nuk ka përdorur sistemin e-pasuria për pranimin dhe shpërndarjen e materialeve shpenzuese/stoqeve. Po ashtu nuk kishte arritur të harmonizoj regjistrat e pasurisë me raportet e inventarizimit në të gjitha gjykatat dhe degët, përjashtimisht Sekretariatit të KGjK-së.

Kjo kishte ndodhur nga mungesa e përgjithësisë së zyrtarëve të pasurive në njësitë e KGjK-së dhe mungesës së mbikëqyrjes në nivel të përgjithshëm të organizatës.

Ndikimi Mos evidentimi i materialit shpenzues/stoqeve dhe mos harmonizimi i gjendjes së pasurisë me regjistrin kontabël rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre. E gjithë kjo ndikon që vlera e pasurisë së pasqyruar në PFV të mos jetë e saktë dhe e drejtë.

Rekomandimi C2 Kryesuesi i KGjK-së duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë duke vënë në funksion të plotë të sistemit e-pasuria dhe të siguroj që regjistrat e pasurisë të harmonizohen me raportet e inventarizimit me qëllim të ruajtjes nga keqpërdorimet e mundshme të pasurisë dhe raportimin e drejtë të saj në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	34,155,572	32,888,599	30,781,798	29,552,128	28,028,490
Grante Qeveritare - Buxheti	32,491,332	30,815,636	29,930,965	27,809,641	26,363,280
Të bartura nga viti i kaluar	0	122	0	4,410	0
Të hyrat vetanake	1,664,240	1,664,240	594,026	1,586,628	1,644,349
Donacionet e jashtme	0	408,601	256,806	151,449	20,861

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,266,973€. Ky ndryshim ishte rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura për 122€, rritjes me donacione për 408,601€ dhe pastaj zvogëlimit nga shkurtimet buxhetore për 1,675,696€.

Në vitin 2023 KGjK ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 30,781,798€, që është përqindje e njëjtë e realizimit sikurse në vitin 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	34,155,572	32,888,599	30,781,798	29,552,128	28,028,490
Pagat dhe mëditjet	25,697,572	24,704,033	23,561,547	23,888,963	23,277,174
Mallrat dhe shërbimet	4,428,000	5,329,444	5,092,450	3,874,613	3,491,931
Komunalitë	400,000	400,000	325,475	317,140	328,195
Subvencionet dhe transferet	500,000	500,122	497,006	499,878	457,501
Investimet Kapitale	3,130,000	1,955,000	1,305,320	971,534	473,689

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Tek pagat dhe mëditjet, buxheti përfundimtar është zvogëluar për 993,539€. Ky ndryshim është rezultat vendimit të qeverisë nr.69/2023, të datës 27.12.2023 për kursime buxhetore në vlerë prej 1,300,696€ dhe rritjes nga grandet e donatorëve prej 307,157€. Realizimi në këtë kategori ishte 23,561,546€ apo 95%. Kursimet buxhetore kishin ndodhur nga mos plotësimi i pozitave të punës të cilat ishin të planifikuara me buxhet.


- Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 901,444€. Kjo rritje është rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 800,000€ me kërkesë të KGJK-së dhe vendimit të ministrit të financave nr.198/2023 të datës 05.10.2023, si dhe grandeve të donatorëve prej 101,444€. Realizimi ishte 5,092,450€ apo 95%.

- Tek komunalitë, buxheti fillestar dhe ai final është i njëjti, ndërsa realizimi ishte 325,475€ apo 81%.

- Tek subvencionet dhe transferet, buxheti përfundimtar është rritur për 122€ i rezultat i bartjes së të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2022. Realizimi ishte 497,006€ apo 99%.

- Tek investimet kapitale buxheti përfundimtar është zvogëluar për 1,175,000€. Zvogëlimi prej 800,000€ është nga bartja e mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe 375,000€ për kursime buxhetore sipas vendimit të qeverisë nr.69/2023, të datës 27.12.2023. Realizimi ishte 1,305,320€ apo 67%. Zvogëlimi i buxhetit dhe niveli ulët i shpenzimeve, janë rezultat i mos realizimit të tri projekteve kapitale të planifikuara. Për projektet "Blerja e automjeteve për Gjykata dhe KGJK" dhe "Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit Gjykatës Themelore në Pejë", nuk kanë arritur të përfundojnë procedurat e prokurimit pasi që kishte ankesa në OSHP, ndërsa projekti "Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Arkivit Qendrorë të gjykatave dhe Gjykatës Supreme", nuk është realizuar për shkak të mos përfundimit të procesit për bartjen e pronës nga Komuna e Prishtinës në KGJK.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në 2023 ishin në vlerë 10,191,248€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, taksat gjyqësore, të hyrat nga lëshimi i licencave për shërbime profesionale, gjobat dhe taksat nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Krahasuar më vitin paraprak kemi rritje të të hyrave për 369,651€ apo 4%. Kjo rritje kryesisht ka të bëjë me rritjen e të hyrave nga lëshimi i licencave për shërbime profesionale.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	10,114,242	10,114,242	10,191,248	9,821,598	9,019,139
Të hyrat jo tatimore	10,114,242	10,114,242	10,191,248	9,821,598	9,016,883
Të hyrat tjera	0	0			2,256

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të Këshillit Gjyqësor ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. KGjK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, dy (2) rekomandime janë zbatuar, dy (2) rekomandime pjesërisht janë të zbatuara, ndërsa një (1) rekomandim nuk është adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryesuesi i KGjK-së duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë dhe nëpërmjet Administratorëve të Gjykatave, duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale regjistrohen në regjistra përkatës sipas kërkesave ligjore. Po ashtu duhet siguruar krahasimi i gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektohen ndryshimet eventuale në PVF.	Përdorimi i sistemit e-pasuria ka filluar në vitin 2023, mirëpo nuk është vënë në funksion për menaxhimin e materialeve shpenzuese/stoqeve. Po ashtu nuk janë harmonizuar regjistrat e pasurisë me raporte të inventarizimit.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Baza për opinion	Kryesuesi i KGjK-së duhet të siguroj që blerjet e pasurisë jokatiale të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV. Më tutje, të sigurohet se zhvlerësimi i këtyre pasurive do të bëhet duke përdorur normat e zhvlerësimit e përcaktuara me rregullore, varësisht nga koha reale e blerjes së këtyre pajisjeve.	Është identifikuar mos regjistrim i pasurisë/blerjeve të vitit nëpër Gjykata dhe degë, për kundër përpjekjeve të vazhdueshme të drejtorit të përgjithshëm që të bëhet regjistrimi i pasurisë nga të gjithë zyrtarët e pasurisë në njësitë administrative të KGjK- së. Sa i përket zhvlerësimit nuk kemi identifikuar ndonjë gabim.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesi duhet të siguroj planifikim me kohë të procedurave të prokurimit në mënyrë që fondet e parave të imëta të shfrytëzohen vetëm për të paguar blerjet e ndryshme me vlera të vogla, të cilat paraqiten në raste të paparashikueshme. Më tutje, të siguroj harmonizimin e UA të brendshëm me rregulloren 01/2013, sa i përket shpenzimit të parasë për drekave zyrtare.	KGjK ka shfuqizuar rregulloren që paraja imët të përdoret për dreka zyrtare dhe të gjitha blerjet /shpenzimet janë bërë për raste të paparashikueshme, sipas rregullores 01/2013.	I zbatuar
4.	Obligimet e papaguara	Kryesuesi i KGjK-së duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen në brenda afatit prej 30 ditëve nga pranimi i faturës, me qëllim të menaxhimit të duhur të fondeve publike.	Edhe këtë vit ka rezultuar të ketë vonesa në pagesën e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Detyrimet Kontigjente	Kryesuesi i KGjK-së duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e detyrimeve kontigjente në mënyrë që të mundësohet regjistër i saktë i detyrimeve kontigjente dhe raportim i drejtë në PFV.	Zyra ligjore ka rishikuar të gjitha lëndët/paditë dhe ka prezantuar vlerën e saktë të detyrimeve kontigjente.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Siç e dini dhe siç jeni të njoftuar edhe gjatë fazës së auditimit, buxheti për pagesat përkatësisht kompensimin e dëmit për personat e arrestuar apo të dënuar pa arsye, planifikohet në kategorinë ekonomike “subvencione dhe transfere” nga të hyrat vetanake fondi burimor 21 të cilat mjete alokohen pas gjenerimit (arkëtimit) të hyrave gjatë vitit fiskal.</p> <p>Me Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023, në këtë kategori janë ndarë vetëm 500,000 €.</p> <p>Edhe pse është vështirë e parashikueshme shumat e kompensimeve apo buxheti i nevojshëm në vazhdimësi ndër vite kemi kërkuar nga qeveria dhe kuvendi që në këtë kategori të ndahen mjete të mjaftueshme për kompensim të dënuarve sipas vendimeve gjyqësore. (shih dëshmitë e bashkangjitura të kërkesave buxhetore 2023-2024).</p> <p>Gjatë vitit 2023 janë shpenzuar të gjitha mjetet në këtë kategori më konkretisht 99.38 % e buxhetit të ndarë. (shih dëshminë e bashkangjitur Tabelën)</p> <p>Thesari me datën 22 dhjetor 2023 me email na ka njoftuar se ka pranuar kërkesën për ekzekutimin e dy urdhërave përmbarimor sipas vendimeve gjyqësore në shumë prej 270,224 €, me të cilën kërkesë është kërkuar nga ne që brenda dy ditëve të punës të njoftojmë Thesarin se a është ekzekutu kjo pagesë në mënyrë që të shmanget pagesa e dyfishtë nga ana e tyre. (shih dëshminë e bashkangjitur-emailin).</p> <p>Thesarin e kemi njoftuar që pagesa nuk është ekzekutu nga KGjK, dhe se nuk kemi mjete mjete në kategorinë përkatëse. Në mënyrë që mos të na tërhiqen nga Thesari mjetet nga kategoria e mallrave dhe</p>	<p>KGjK me komentimin e saj për këtë gjetje ka konfirmuar se në mungesë të mjeteve në kategorinë e subvencioneve (ashtu siç është trajtuar në raport) ka sugjeruar Thesarin që këto pagesa të kryejnë nga kategoria e investimeve kapitale.</p> <p>Mungesa e mjeteve nuk e arsyeton prezantimin jo të drejtë të këtyre shpenzimeve në PFV. Po ashtu, kjo gjetje është trajtuar në aspektin e realizimit të shpenzimeve e jo në aspektin e planifikimit të buxhetit siç është komentuar nga KGjK.</p> <p>Sa i përket dëshmitë të përcjella, të njëjtat ne i kemi analizuar edhe gjatë punës audituese, bazuar në të cilat është paraqitur edhe e gjetura. Sipas metodologjisë së auditimit, vlera e kësaj gjetje së bashku me gabimet e tjera është materiale dhe e ndikon opinionin e auditimit.</p> <p>Prandaj e gjetura dhe rekomandimi qëndrojnë.</p>

shërbimeve për të cilën kategori kemi patur mungesë të buxhetit dhe për të cilat kemi bërë dy herë gjatë vitit transfere nga kategoria e shpenzimeve kapitale në përqindje deri në 25% sipas ligjit të buxhetit. Thesarit i kemi propozuar që këto mjete të tërhiqen nga buxheti i lirë (i pashpenzuar) i një projekti kapital, pra nga kategoria e shpenzimeve kapitale. (shih dëshminë e bashkangjitur-emailin).

Keq klasifikim apo klasifikimi jo adekuat i kodeve ekonomike sipas planit kontabël mund të konsiderohet në rastet kur edhe planifikohet gabim në kodin jo përkatës buxheti, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me planifikim të buxhetit gabim por me mungesë të buxhetit për të cilin kemi kërkuar në vazhdimësi siç e kemi cekur më lartë, pra kemi vetëm shpenzim i cili është bërë nga Thesari e jo nga KGjK.

Për arsye të lartpërmendura nuk pajtohemi me këtë rekomandim rezultat i të cilit është edhe kualifikimi i opinionit, sepse sikur të na ishte ndarë buxheti i vitit 2023 nga qeveria dhe kuvendi sipas kërkesës buxhetore të KGjK në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në shumën totale prej 690,000 € (190,000 € shtesë) nuk do të kualifikohej opinionit në draft raport, prandaj konsiderojmë se nuk nuk ka bazë për kualifikim si dhe kërkojmë që në raportin final të mos kemi kualifikim të opinionit, por Opinion të pa-modifikuar.

<p>Nënvlerësimi i pasurisë jo kapitale</p>	<p>Lidhur me nënvlerësimin e pasurisë jo kapitale, për shkak të mos regjistrimit në sistemin "e-pasuria" e inventarit në vlerë prej 75,126 € nga njësit administrative të KGjK, përkatësisht nga Gjykatat, kjo ka ndodhur për shkak se shumica e këtij inventari është pranuar nga gjykatat në fund të vitit 2023 (muajin nëntor, dhjetor 2023) me të cilin inventar edhe është bërë ngarkim/shkarkimi nga zyrtarët kompetent, por nuk janë regjistru në sistemi në atë kohë.</p> <p>Mos regjistrimi në sistem nuk është bërë për arsye se zyrtarët e gjykatave kanë qenë të angazhuar me procesin e inventarizimit në fund vit. (shih dëshmitë e bashkangjitura -fletë dërgesat e inventarit të pranuar nga Gjykata Themelore e Prizrenit dhe Ferizajit në muajin nëntor dhe dhjetor 2023).</p> <p>Vlen të theksohet se numri i njësive të inventarit të paregjistruar në sistem është më pak se 2% e numrit të atyre të regjistruara në sistem, përqindje e përafërt është edhe vlera e atyre të paregjistruara në krahasim me ato të regjistruara.</p> <p>Siç ju kemi dëshmuar edhe me raporte ky inventar në gjykatat e cekura është regjistru në sistemin e-pasuria në vitin 2024.</p> <p>Për arsye të lartpërmendura nuk pajtohem edhe me këtë rekomandim rezultat i të cilit është edhe kualifikimi i opinionit.</p>	<p>KGjK ka paraqitur shpjegimet për mungesën e kohës për regjistrim dhe dëshmitë në lidhje me pranimin e këtyre pasurive në nëntor (21.11.2023) dhe dhjetor (07.12.2023). Ne konsiderojmë, se çdo pasuri e pranuar duhet të regjistrohet në regjistrat përkatëse pavarësisht vlerës dhe se koha për regjistrimin e këtyre pasurive ka qenë e mjaftueshme për ti përfshirë/regjistruar në regjistrin e pasurisë të vitit 2023.</p> <p>Sa i përket dëshmive të përcjella, të njëjtat ne i kemi analizuar edhe gjatë punës audituese, bazuar në të cilat është paraqitur edhe e gjetura.</p> <p>Prandaj e gjetura dhe rekomandimi qëndrojnë.</p>
<p>Dhënia e kontratës me çmime jo-normalisht të ulët për pozicione të caktuara</p>	<p>AK-KGjK nuk pajtohet me këtë rekomandim për këto arsye: Rregullorja 001/2022 Për Prokurim Publik në nenin 41- Tenderët jo normalisht të Ulet sqaron si të veprohet në rastet që për AK në shikim të parë duken Tenderët si Jo normalisht të ulet në raport me objektin e kontratës. Para dispozitave të 41.9 dhe 41.6 të këtij neni që i referohen auditorët, janë edhe dispozitat tjera si 41.1, 41.2 dhe 41.3 e cila shpjegon që AK do të kërkojë nga operatorët ekonomik për</p>	<p>Kriteri mbulon në tërësi të dy rastet e trajtuara në këtë gjetje, bazuar në këtë kriter obligohet autoriteti kontraktues në këtë rast KGjK që për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit të kërkohet nga tenderuesi sqarime shtesë për çmimet jo normalisht të ulët duke përdorur formularin standard.</p> <p>Numri i lartë i pozicioneve nuk e përjashton nga përgjegjësia për të kërkuar sqarime nga tenderuesi, veçanërisht për pozicione të cilat janë kyçe dhe ndikojnë në zbatim të</p>

te shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ne rastin e projektit të Mitrovicës, asnjëri prej dy kushteve të mësipërme të nenit 41.3 të rregullores 001/2022, nuk janë përmbushur, në mënyrë që ne të kërkojmë shpjegim për çmimin e ofruar në disa pozicione që konsiderohen si jo normalisht të ulëta nga Auditorët. Ne si AK kemi vepruar në përputhje me këtë rregullore në rastin e çmimeve jo normalisht të ulëta

Në këtë projekt kemi pasur tre tender të përgjegjshëm me çmimet si ne vijim:

Nr. Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik

Vlera totale e ofertës

1. Oferta Fituese Grup i Operatorëve Ekonomik HIDRO PROJECT SH.P.K.; ,, ENGRUP SH.P.K.

çmimi total i ofertës 1,274,867.11€
I suksesshëm

2 Grup i Operatorëve Ekonomik FlorinG SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K. çmimi total i ofertës

1,280,154.53€

I pa suksesshëm

3 Olti Trasing SH.P.K. çmimi total i ofertës 1,288,800.00€

I pa suksesshëm

(shih dëshminë e bashkangjitur-tabelën).

Pra nga tabela e mësipërme shihet se tri ofertat e përgjegjshme kanë çmime mjaft konkurruese, Dallimi prej ofertës së Fituese me ofertën e dytë është vetëm 5.287 €. dhe me ofertën e tretë është rreth 14.000 €.

E gjetura e Auditorët thotë që në ofertën fituese rreth 6 pozicione kanë çmime jo normalisht të ulët për të cilat sipas nenit 41.6 të rregullores është dashur të kërkohej shpjegim prej operatorit ekonomik.

projektit për të cilat vlera e tregut është shumë më e lartë se ajo që është ofruar (p.sh.1€/pozicion). Sa i përket dëshmive të përcjella, të njëjtat ne i kemi analizuar edhe gjatë punës audituese, bazuar në të cilat është paraqitur edhe e gjetura.

Prandaj e gjetura dhe rekomandimi qëndrojnë.

	<p>Pra AK thekson se, Oferta fituese ne total ka rreth 700 pozicione, prej tyre 6 pozicione janë konstatuar nga auditorët me çmime jo normalisht te ulet. Nga kjo shihet se ne raport me vlerën e kontratës dhe tërësinë e pozicioneve ne listën e çmimeve kemi te bëjmë me një numër te pa përfillshim te pozicioneve me çmime te ulëta, për ta kualifikuar në tërësi ofertën fituese me çmime si jo normalisht te ulet.</p> <p>Pjesa tjetër e Rekomandimit A2 qe ka te beje me procedurën e Prokurimit "Furnizim me Inventar për Salla te gjykimeve dhe zyrave te shkrimoreve ne gjykata dhe SKGjK, ku OE fitues ne krejt listën e çmimeve ne kontrate ka pasur 51 pozicione (artikuj) dhe prej tyre auditorët kane konstatuar qe dy pozicione kane çmime jo normalisht te ulëta për te cilët AK nuk ka kërkuar shpjegim prej OE fitues për çmimet e dhëna. Fjala është për këto artikuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Tavoline për takime me 22 karrika dhe -Tavoline për takime me 8 karrika <p>Koha na ka dëshmuar se kemi vepruar drejte ne këtë rast sepse pikërisht për këto dy pozicione OE ka bere furnizimet e nevojshme sipas kërkesave te gjykatave dhe AK-se. Si dëshmi për këtë ju ofrojmë dhe faturat për këta dy artikuj qe kemi bere furnizime ne gjykata dhe SKGjK. (shih dëshminë e bashkangjitur-tabelat)</p> <p>Prandaj nuk pajtohemi edhe me pjesën e dyte te rekomandimit A2.</p>	
<p>Vonesa në pagesa të obligimeve</p>	<p>Për shkak të ndarjes së pamjaftueshme të buxhetit në vitin 2022 dhe 2023, kryesisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për të cilën kategori nga viti 2022 në vitin 2023 janë bartë obligime në vlerë mbi 500,000 € por edhe në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve mbi 70,000€.(shih dëshmitë-raportet e obligimeve të papaguara të muajit dhjetor 2022 dhe janar 2023).</p> <p>Në vitin 2023 nuk ka patur as</p>	<p>Vonesat në pagesa të obligimeve përfshijnë gjithë periudhën e vitit 2023 dhe nuk i përkasin vetëm muajve të fundit të vitit. Dy prej faturave të cilat ishin pranuar në dhjetor 2023, ishin paguar në muajin shkurt, respektivisht mars 2024. Këto fatura i përkasin vitit 2023 dhe për këtë arsye janë trajtuar në raportin e auditimit të vitit 2023. KGjK mund të paraqet shkaktarët e këtyre vonesave për mos pagesën me kohë të obligimeve, mirëpo këto</p>

rishikim të buxhetit, gjë që na ka shkaktuar vështirësi në menaxhim të pagesave për të cilat disa herë gjatë vitit kemi bërë kërkesa për transfer të buxhetit nga kategoria e shpenzimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve deri në 25 % të kategorisë përkatëse e lejuar sipas LMFPP dhe sipas ligjit të buxhetit.

Edhe gjatë fazës së auditimit ju kemi ofruar dëshmitë e kërkesave buxhetore dhe të kërkesave për transfere të cilat janë vërtetuar dhe konstatuar nga ekipi i auditimit, ndërsa në draft raport është cekur se ky rekomandim nuk është adresu, për më tepër rreth 40 % e mostrave të përzgjedhura nga ZKA për obligimet e papaguara (te paguara me vonesë) janë të fund vitit (muaji nëntor, dhjetor 2023) për të cilat edhe sikur të kishim buxhet të mjaftueshëm nuk do të mund të ekzekutoheshin sepse afatet e zotimeve dhe shpenzimeve janë të përcaktuara me rregullore të Thesarit.

Për ilustrim dhe informimin tuaj një mostër e përzgjedhur nga ZKA e pagesës me vonesë, për kompensim të dëmit personit të dënuar pa arsye, përkatësisht Ujdia (Marrëveshja) për kompensim në mes të komisionit kompetent të KGJK dhe përfaqësuesit ligjor të të dënuarit pa arsye është bërë me 15.12.2023, kërkesa për pagesë me 18.12.2023, e cila duhet të ekzekutohet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për të cilën buxheti ka qenë i shpenzuar shumë më herët në përqindje prej 99.38 % siç e kemi cekur në komentin e çështjes A1. (shih dëshminë e bashkangjitur-kërkesën për pagesë, ujdinë (marrëveshjen) për kompensim dhe pagesën e ekzekutuar në vitin 2024).

Po ashtu buxheti në këtë kategori planifikohet nga të hyrat të cilat duhet fillimisht të arkëtohen nga gjykatat pastaj të alokohen nga Thesari për shpenzim sipas planit të rrjedhës së parasë.

Sipas rregullave dhe procedurave të

nuk e ndryshojnë gjendjen dhe tejkalimin e afatit ligjor të pagesave prej 30 ditëve. Për më tepër kjo gjetje është e përsëritur nga viti paraprak.

Sa i përket dëshmive të përcjella, të njëjtat ne i kemi analizuar edhe gjatë punës audituese, bazuar në të cilat është paraqitur edhe e gjetura.

Prandaj e gjetura dhe rekomandimi qëndrojnë.

Thesarit pas aprovimit të buxhetit nga kuvendi dhe hyrjes në fuqi të Ligjit për ndarjet buxhetore, për ekzekutim të buxhetit në çdo vit fiskal në fillim duhet të përgatiten dhe dorëzohen në Thesar qasjet për të gjithë zyrtarët e certifikuar nga vet Thesari, pastaj duhet të alokohet buxheti po nga Thesari sipas planit të rrjedhës së parasë nga organizatat buxhetore.

Të hyrat vetanake duhet fillimisht të arkëtohen pastaj të alokohen për ato organizata që kanë të drejtë të shfrytëzojnë (KGJK nga të hyrat vetanake i kompenson të dënuarit dhe të arrestuarit pa arsye sipas vendimeve gjyqësore të cilat mjete janë të planifikuara në kategorinë subvencioneve dhe transferove të cekura edhe në komentet e çështjes A1).

Pothuajse asnjë organizatë buxhetore nuk ka mundësi të fillojë ekzekutimin e buxhetit në muajin janar, duke patur parasysh se përveç të lartëcekurave në këtë muaj jemi të angazhuar në përgatitjen e raportit vjetor financiar-pasqyrave vjetore financiare për vitin paraprak, të cilin raport e kemi obligim ta përgatitim dhe dërgojmë në Thesar-MFPT dhe një kopje në ZKA, 30 ditë pas përfundimit të vitit fiskal.

Për arsye të lartpërmendura dhe arsyeve tjera shumë prej të cilave i kemi diskutuar edhe me ekipin tuaj nuk pajtohemi me këtë rekomandim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KESHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Mr.Br.No.	01 / 459
DAT.DT.	28.05.2024
	PRISHTINE - A

LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me dy (2) gjetje dhe rekomandime, për gjetjen dhe rekomandimin A3 dhe C2 ndërsa nuk pajtohem me katër (4) gjetje dhe rekomandime, për gjetjen dhe rekomandimin A1;C1;A2 dhe B1 për të cilat kemi dhënë dhe i keni të bashkangjitura komentet dhe dëshmitë për gjetjet dhe rekomandimet e cekura në përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Data: 28 Maj 2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Çështja B1 - Vonesa në pagesa të obligimeve, janë: Pagesa për ekspert gjyqësor - 500€, Shpenzime postare - 11,778€, Shpenzime të përfaqësimi - 366€, Shpenzime postare - 5,844€, Pulla postare - 7,094€, Kompenzimi për të dënuarit pa bazë - 6,947€, Pagesa për ekspert gjyqësor -2,000€ dhe Shpenzimet përfaqësimit - 170€.
- ⁶ Çështja A3 - Mos përdorimi i modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve, janë: dy raste për furnizime: Furnizim me licenca, në vlerë 102,865€ dhe Furnizim me material të shtypur, në vlerë totale indikative prej 276,654€, si dhe në katër raste për ndërtime: Ndërtimi i Gjykatës Themelore Gjilan - Dega Viti, në vlerë 767,783€; Ndërtimi i Gjykatës Themelore Prishtine - Dega Drenas, në vlerë 695,239€; Renovimi i objektit të Gjykatës Themelore Mitrovicë - Jug, në vlerë 1,274,867€ dhe Riparimi dhe mirëmbajtja e Gjykatave dhe SKGJK-së, në vlerë 467,911€.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.